



RAPORT TOPOGRAFIK

“Rikonstruksioni objekteve të ish Repartit "Renea" për Akomodimi e Drejtorisë Forcës së Posaçme Operacionale”

(FAZA PROJEKT-ZBATIM)

PROJEKTUES	Inxhinier Topograf	SUBJEKTI POROSITES	Rev
“INSTITUTI DEKLIADA-ALB” sh.p.k	Ing.Kamber Balla	DREJTORIA E PERGJITHSHME E POLICISE SE SHTETIT	00
		Miratuar	
		Nr. fq/Formati /A4	2020 Tirane
	<u>RAPORT TOPOGRAFIK</u>		

PERMBAJTJA

1.	RAPORTI TOPOGRAFIK.....	3
1.1	Instrumentat dhe metodeologjia.....	3
1.1.1	Zgjedhja e instrumentave dhe aparaturave.....	4
1.1.2	Rilevimi.....	4

1. RAPORTI TOPOGRAFIK

1.1 Instrumentat dhe metodeologjia

Punimet gjeodezike dhe topografike për objektin u kryen mbi bazen e kerkesave teknike të pergjithshme dhe specifike të kerkuara. Grupi i topografeve organizoi punën dhe zhvilloi punimet në bazë të përvijës së përfunduar në punimet e mëparshme të kësaj natyre. Para fillimit të punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe pajisjet përkatëse.

Sistemi koordinativ i përdorur për matjen e objekteve është sistemi Global UTM Zona 34N me ellipsoid WGS84. Duke patur parasysh zonën dhe ritmin e zhvillimit që ajo ka, është me frytedhënie përdorimi i këtij sistemi. Me këtë sistem mund të përcaktohen lehtësisht koordinatat gjeodezike për çdo pikë mbi sipërfaqën tokësore nëpërmjet përdorimit të GPS.

Si sistemi referues është përdorur Sistemi Shtetëror i Pozicionimit “AlbCors”. I cili është pjesë e “Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësino”.

Gjatë rikonicionit në terren u vendosën pikat e poligonit të fiksuara në terren. Pikat e fiksuara në terren u pajisën me koordinatat e tyre përkatëse sipas sistemit koordinativ UTM dhe ellipsoid WGS84. Para fillimit të rievimit u krye rikonicioni i detajuar i terrenit, i cili shërbeu për përcaktimin e saktë të metodikës së punës, mënyrës e ndërtimit të rrjetit gjeodezik, poligonometrise së rievimit, nivelimit teknik si dhe organizimit të punës.

Fiksimi në terren i pikave poligonale të rievimit u krye me gozhde betoni të ngulura në zone të qëndrueshme dhe rezistente në kohë. Ato janë vendosur në vende të dukshme dhe të shënuara me numrin përkatës. Identiteti i tyre është fiksuar me boje të kuqe të shkruajtur në afërsi të pikës fikse në vende të dukshme nga rruga ekzistuese ose terreni. Ato janë vendosur në vende të qëndrueshme, në anë të rrugës ose afër saj, kanë pamje të ndërsjellta, duke siguruar në këtë mënyrë lidhjen dhe vazhdimësinë e punës nga faza e projektimit në atë të zbatimit të tij.

Çdo pikë e fiksuar në terren ka numrin, koordinatat e saj, si dhe lartësinë (shih planimetritë e objekteve ku gjenden koordinatat e pikave mbështetëse). Këto të dhëna sigurojnë gjetjen e tyre me lehtësi në terren.

Pikat fikse të terrenit janë të përcaktuara në planimetritë e objektit që përfshihet në projekt.

1.1.1 Zgjedhja e instrumentave dhe aparaturave

Duke njohur tashme karakteristikat e situates urbane , e cila ne teresine e saj eshte zone me dendesi urbane te larte dhe vizualitet te kufizuar, Grupi topografik zgjodhi dhe operoi ne terren me GPS Top Con Hiper SR, si per ndertimin e rrjetit mbeshtetes dhe kompletimin e detajeve te relievit .

GPS TopCon Hiper SR

Saktesia:

RTK (L1+L2):

H: 10 mm + 0.8 ppm

V: 15 mm + 1.0 ppm

Matjet e objekteve u kryen me anë të Stacionit Total SOKKIA SRX1X me saktësi matje këndore 1”(një sekond), duke zbatuar metodikat më të përshtatshme dhe më moderne të rilevimit që japin garanci për vlerësimin me saktësi të riskut dhe me parametra teknik si më poshtë.

- Magnification / resolution: 30x / 2.5 "
- Angular measurement accuracy: 1 "
- Distance measurement accuracy: o Reflectorless: +/- (2 + 2ppm) mm
o Foil: +/- (2 + 2ppm) mm
o Prism: +/- (1.5 + 2ppm) mm
- Angular velocity: 60 ° / sec

Karakteristikat fiziko - teknike te ketyre aparaturave si dhe saktesitë e garantuara në percaktimin e pozicionit të pikes, së bashku me kompatibilitetin e perpunimit të të dhenave në programet kompjuterike si edhe metodika e matjes , garantojne saktesine e kerkuar nga parametrat teknike te projektimit dhe te zbatimit

1.2 Rilevimi

Duke u mbështetur në pikat poligonale e hedhura nga Sistemi AlbCors është bërë shpeshtimi i rrjetit të poligonometrise me ane të stacionit Total.

Është rilevuar ne menyre të plote e gjithë gjurma e objektit duke marrë pikë ne Katin 0 dhe pike ne Katin e fundit ku shtrihet objekti si dhe e nje brezi perimetral te rrugeve qe e qarkojne atë. Në relief jane pasqyruar në menyre të plote të tëre elementet përbëres te tij ku ka pas thyerje objekti, si dhe shtesat. Punimet topogjeodezike të kryera jane mbeshtetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik e te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit. Çdo pikë e marrë në terren ka koordinata, te paraqitura ne projekt.

Perpunimi i materialit topografik ne zyre eshte bere me programin Autocad Civil si dhe ArcGis nga ku është përfutur rievimi tre dimensional. Ky riev s herben si bazë për pozicionim e saktë të objekteve.

Ne materialin grafik te projektit jepet rievimi i objektit si dhe pikat e Poligonometrise.

Reparti “Ish Renea” eshte me dalje ne rrugen kryesore “Muhamed Deliu”.Reparti ndodhet 20min larg me automjet nga qendra e Tiranes. Rruga qe lidh qendren me kete zone eshte 6 km pergjate “Xhenfize Kekos” dhe “Hoxha Tahsim”




Figura 1-1 Relievi i siperfaqes ndertimit



Figura 2 Ortofoto

Territori i propozuar per ndertimin e DFPO-se eshte prona e “Ish Reneas”.

- Në pjesën Veriore të truallit kufizohet nga kodër me shkurre;
- Në pjesën Lindore kufizohet nga pronë private;
- Në pjesën Jugore kufizohet nga rruga "Muhamet Dalli"•
- Në pjesën Perëndimore kufizohet me blloqe godina banimi.




Figura 3 Genplani i Ish Reneas